

AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJESI TË KUFIZUAR  
“ CASA KONSTRUKSION” shpk

Ne perputhje me ligjin nr. Nr.9901, datë 14.4.2008, “ Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare ”, Ligjin nr. 9723, datë 3.5.2007 “ Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit ,Kodin Doganor, Fiskal e Tatimor, krijohet shoqeria tregtare sot me date 30.03.2024 me pergjegjesi të kufizuar, me emertimin “ **CASA KONSTRUKSION” shpk** shpk

*KREUI*

Emertimi. Forma Juridike. Selia. Kohëzgjatja. Objekti

Neni 1

Emertimi

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “ **CASA KONSTRUKSION” shpk**

Neni 2

Forma Juridike

Shoqeria “ **CASA KONSTRUKSION” shpk**, eshte person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqeri me pergjegjesi te kufizuar (me poshte e quajtur “Shoqeria”), e themeluar nga nga ortakut i vetem, i cili nuk pergjigjet për detyrimet e shoqërisë tregtare dhe mbulon personalisht humbjet e shoqërisë deri në pjesën e pashlyer të kontributeve të nënshkruara. Kontributi i ortakut përbën kapitalin e regjistruar të shoqërisë.

Shoqeria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombetare te Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligji.

Shoqeria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimtarisë së saj.

Neni 3

Selia

Shoqeria e ka seline ne Fier ,Lagjia Kastriot, zona kadastrale 8534, nr pasurie 1/1231-N16 VOL.39 FAQE 48 me sipërfaqe 45.50m2, e cilesuar Njesi.

Shoqeria mund te ndryshoje seline e saj, te hape zyra perfaqesie, dege, te krijojte filiale, si brenda ashtu edhe jashte Republikes se Shqiperise, vetem me vendim te Asamblese se Ortakeve.

Neni 4

Objekti

Shoqeria “ **CASA KONSTRUKSION” shpk** ka per objekt kryerjen e cdo aktiviteti te lejuar me ligji dhe/ ose pjesemartine ne cdo veprimtari apo aktivitet te ligjshem qe mund te kryej nje shoqeri me pergjegjesi te kufizuar ne baze te legjislacionit shqiptar ne fuqi dhe, ne vecanti :

“Nderim, rikontruksion, restaurim ne fushen e ndertimit teobjekteve te ndryshme civile - industriale, private dheshetrore, social kulturore dhe agjensi per shiblerjen e ketyrendertimeve. Nderim godina banimi si me fondet e veteshogerise ashtu dhe me fonde publike dhe kredi bankare.Nderime me karakter social, kulturor dhe te kulture tendryshme

fetare si dhe restaurimeve, etj. Nderime dheriasfaltime rrugesh dhe autostradash, punime te sinjalizimitrrugor etj. Nderitime veprash te medha hidroteknike,portuale, aeroportuale e te kanterereve detare, puse, cpimegjeologo inxhinierike, cpime per uje etj. Kryerje punimesh tenxhinierise civile te te gjitha llojeve te veprave te artit,riparim dhe mirembajtje te veprave ekzistuese, izolim mbidhe nentokesore nga ujrat siperfaqesore te siperfaqeve tegjelberta si pyje, parqe etj. Ne nderimin, mirembajtje dherestaurimin ujesjellesi dhe KUZ-ve, KUB-ve, etj.Administrim I guroreve, implanteve te betonit, implanteve tekonglomerateve bituminoze dhe te copezimit. Sherbime tenatyles se projektimeve, drejtimit dhe ndihmes teknike te punimeve me personel te kualifikuar, rlevime topografike,punime topogjodezike, qendrushmeri dhe perforcimthemelesh, nderitim dige te larte, etj. Prodhim, fabrikim dheiregum materiale nderitimi, inerte, prodhimeve te betonit, etj.Projektim, nderitim, te objekteve civile, social kulturore,ekonomike, industriale, objekte banimi, qendra tregtare,nderitim rrugesh, nderitim veprash arti, arkitektonike,nderitime mjedisesh rekreative, linja hekurudhore,rikonstruksion rrugesh, te veprave te ndryshme industriale etregtare. Sherbime te punimeve mekanike, ngrohje,kondicionim dhe hidrantit kundra zjarrit. Importeksport,tregetim me shumice e pakice te mallrave te ndryshmeindustriale, bujqesore, nderitimi, elektroshtepiake, pajisjeelektrike, kancelari dhe artikuj kompjuterik, artikuj tendryshem mobilerie, dyer, dritare, paisje ventilimi dhekondicionimi. Tregtim paisje hidraulike, paisje hidrosanitare dhe aksesore te tyre. Pastrim dhe gjelberim te ambientevepublike dhe private. Hoteleri, turizem, bar, restorant. Agjensidhetimelesh turistike. Agjensi imobiliare. Agjensi shijebljetash te transportit urban, hekurudhor, ajror dhe detar.Pike shitje te te gjitha llojeve te karburanteve dheneprprodukteve te tyre me pakice dhe vajrave lubrifikante,javazho, gomisteri, servis mjetesh. Vleresim i pasurive tepalujajshme. Punime gjeodezike, bazamente gjeodezike dherilevime te te gjitha shkalleve.”

Neni 5

Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

## KREU II

### KAPITALI

Neni 6

Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 3.000.000 lekë dhe eshte nënshkruar nga “ asambleja e ortakeve te shoqerise

**Ortaku Themelues:** Aurela Dulla, zoteres i 1 (nje ) kuote , me vlere te pergjithshme 3.000.000 Leke, qe perbene 100 % te kapitali themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajshme/të paluajshme apo të drejta)

Ortaku, që pengohet të ushtrrojë të drejtat që i rrjedhin nga zotërimi i kuotës së shoqërisë, ka të drejtë t'i kërkojë gjykatës të urdhërojë ndalimin e cenimit apo shpërblimin e dëmit të shkaktuar, si pasojë e cenimit të këtyre të drejtave. Kjo e drejtë parashkruhet brenda 3 vjetëve nga çasti i cenimit.

Ky kapital do te ngurtesohet ne Banke pasi te dali NIPPTI i shogerise .

Neni 7

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund

të ftohën apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontribuit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- ç) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim ( me akt noterial)

Kalimi i kuotave me shite apo dhurim apo cdo forme tjetër ( duke periashtuar trashëgimie ) mund te behet vetem me pelqimin e shogerise .

Ne rast tjetersimi me kundershperblim do te zbatohet e drejta e parableries se kuotave nga ortaket e shogerise .

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidare ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombetare te Regjistrimit, sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

**KREU III**

**ORGANET VENDIMMARRSE DHE DREJTUES**

Neni 8

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shogerise.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shogerise qe miraton cdo ndryshim te statutit sipas modaliteteve te percaktuara ne kete statut.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

- gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;  
h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblese;  
i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
- Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
- Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
- Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.
- Cdo ortak ka te drejta vote ne perpiestim me vleren nominale te knotes se tij.**

Neni 9

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë, **vendos me votat e te paktën tri të katërtave te zotëruesve te kapitalit te shoqerise.**

Asambleja e përgjithshme **vendos me te nieniten shumice te cilesuar edhe për çështje te tjera si :**

- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
  - c) përcaktimin e shpërblimeve
  - d) mbikëqytjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - e) përfqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet te depozitohet prane QKR per te pasyqruar ndryshimet ne skeden e shoqerise.

Neni 9

Administrimi

Administrator i shoqerise “ **CASA KONSTRUKSION**” shpk eshte znj. Aurela Dulla , atesia Bashkim , e datelindjes 14.09.2004 , lindur ne Fier e banues ne Fshatrat Turistikre Qerret Kavaje, shtetas shqiptar, me Nr Personal: K4591402050 e cila do te ushtrroje funksionet ne kete detyre per nje periudhe 5 vjecare me te drejte ripertertije.

Administratori emerohet dhe shkarkohet me vendim te Asamblese se Ortakeve te shoqerise. Emerimi i administratorit do te behet me votat e te paktën tri të katërtave te zotëruesve te kapitalit te shoqerise.

Shkarkimi i administratorit behet me me votim me shumice te zakonshme sipas parashikimit ne ligji.

Neni 10

Kompetencat

Administratoret kane te drejte dhe detyrohen të dy bashke :

- a) kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;
- b) përfaqësojë shoqërinë tregtare;
- c) kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;

ç) përgatiti dhe nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecursisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paragesin këto dokumente përpara asamblësë së përgjithshme për miratim;

d) krijoi një sistem paralojmërimi në kohën e dhur për trehanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;

dh) kryejë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashkohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

e) raportojë përpara asamblësë së përgjithshme në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

Administratori është i detyruar të thërrasi mbledhjen e Asamblese se ortakëve edhe ne rastet kur :

sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston rreziku që aktivet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 muajve në vazhdim dhe kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të asetëve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara,

Administratori ka të drejte të kryejë të gjitha veprimet e administrimit të zakonshëm e të jashtëzakonshëm. Administratori përfaqëson Shoqërinë përpara të gjitha personave fizike e juridike, publike dhe/ose private vendas apo të huaj, autoriteteve shtetërore Shqiptare apo të huaja, përfshi këtu autoritetet gjyqësore të gjitha shkalleve. Administratori ka të gjitha kompetencat për të vepruar në marrëdhënie me të tretët në emër të shoqërisë, në të gjitha rrethanat me përjashtim të kompetencave që ligji ia jep shprehimisht ortakëve te shoqërisë.

Administratori angazhon shoqërinë në marrëdhëniet me të tretët nëpërmjet akteve që janë në përputhje me objektin e saj.

Shoqëria nuk merr përsipër pasojat ndaj të tretëve kur ajo provon se të tretët e dinin që akti i administratorit e kalonte objektin e shoqërisë ose kur të tretët nuk mund ta injoroni këtë akt në rrethanat e dhëna, duke patur parasysh faktin se vetëm shpallja e statutit nuk është provë e mjaftueshme.

#### Neni 11

##### Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfashimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqërisë ne Qendrën Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

#### Neni 12

##### Prishja dhe likuidimi

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të behet ne cdo kohe :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të asamblësë së përgjithshme;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakëve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e

likuidimit të shogerise, duke caktnuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emerresen shtese “ Shogeri ne likuidim e siper “.

Neni 13

Baza Ligjore

Shogeria do te zhvilloje aktivitetin e saj ne perputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashikohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per Tregtaret dhe Shogerite tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjeter specifik ne Republikën e Shqiperise.

Neni 14

Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shogerise dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 15

Dispozita perfundimtare

Ky akt themelimi u redaktua ne 4 ekzemplare me permbytje dhe vlera te njejta juridike, ne gjuhen shqipe dhe pasi miratohet ne parim dhe nen per nen nga Ortaket themelues te shogerise tregtare

“ **CASA KONSTRUKSION**” shpk, dhe nenshkruhet ne të gjitha kopjet duke vendosur emrin, mbiemrin dhe firmen e tyre origjinale.

**ORTAKU I VETEM**

  


**STATUT I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR**  
**“ CASA KONSTRUKSION” shpk**

## **KREUI**

**Emertimi, Forma Juridike, Selia, Kohëzgjatja, Objekti**

**Neni 1**

**Emertimi**

Emërtimi i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar është “ **CASA KONSTRUKSION” shpk**

**Neni 2**

**Forma Juridike**

Shoqëria “ **CASA KONSTRUKSION” shpk**

, është person juridik i te drejtes shqiptare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (me posthite e quajtur “Shoqëria”).

Shoqëria fiton personalitetin juridik pasi të jetë regjistruar në Qendren Kombëtare të Regjistrimit, në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara me ligj.

Shoqëria, pasi të ketë fituar personalitetin juridik, është përgjegjëse ndaj të tretëve për detyrimet dhe dëmet e shkaktuara gjatë veprimitarisë së saj.

Shoqëria ““ **CASA KONSTRUKSION” shpk**, është një e tille, kapitali i së cilës ndahet në kuota dhe që themelohet nga ortakët që përballojnë humbje vetëm deri në kufirin e vlerës së kontributit të tyre në kapitalin themeltar.

**Neni 3**

**Selia**

Shoqëria e ka seline në Fie, Lagjia Kastriot, zona kadastrale 8534, nr pasurie 1/1231-N16 VOL.39 FAQE 48 me sipërfaqe 45.50 m2, e cilesuar Njesi. Shoqëria mund të ndryshojë selinë e saj, të hape zyra perfaqesie, dege, të krijojë filiale, si brenda ashtu edhe jashtë Republikës së Shqipërisë, vetëm me vendim të Asamblesë së Ortakëve.

**Neni 4**

**Objekti**

Shoqëria “ **CASA KONSTRUKSION” shpk**, ka për objekt kryerjen e çdo aktiviteti të lejuar me ligj dhe ose pjesëmarrje në çdo veprimtari apo aktivitet të ligjshëm që mund të kryejë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar në baze të legjislacionit shqiptar në fuqi dhe,

ne vecanti :

Tregëtim me shumicë dhe pakicë , import eksport me shumicë dhe pakicë solucionesh higjienike ,materiale dentare ,

Prodhim dhe tregëtim me shumicë e pakicë e materialeve të ndërtimit, produkteve qeramike, dekorative, shfrytëzim dhe pëpunimi i produkteve minerare të grupit I-IV

Tregëtim me shumicë dhe pakicë i mallrave industriale, makinerive, pajisjeve dhe pjesë këmbimi të ndryshme ,import eksport i mallrave , makinerive pajisjeve dhe materiale ndërtimi, të pajisjeve hidraulike dhe elektrike, tregëtim i pajisjeve të ndryshme elektroshtepiake , elektronike, hidrosaniare, qeramike dhe të artizanatit .

Import eksport me shumce dhe pakice te sistemeve te kondicionim ventimilit , te sistemeve te ngrohjes ,kaldajave etj .

Prodhim dhe tregetim te artikujve te ndryshem mobilere, dyer, dritare, artikuj duralumini, tregetim paisje zyre, kanceleri, paisje ventilimi dhe kondicionimi,kundra zjarrit.

Pastrim Kimik .

Agjensi udhetimesh turistike. Agjensi imobiliare. Agjensi shitje biletash te transportit urban, hekurudhor, ajror dhe detar.

Import eksport dhe tregetim me shumice e pakice te automjeteve te llojeve dhe tonazheve te ndryshme dhe pjeseve te kembimit per to.

Import, eksport, tregetim te paisjeve dixhitale, radiotelevizive, informatike, komunikacion, industriale, elektrike.

Import eksport, tregetim me shumice e pakice te mallrove te ndryshme industriale, ushqimore, artikuj bujqesor dhe blegtorale, paisje elektronike, elektrike, informatike, elektroshtepiake, konfeksione, metrazhe, lende kimike.

Grumbullim, perpunim, eksport dhe tregetim me shumice e pakice te bimeve medicinale, produkteve dhe nenprodukteve bujqesore, blegtorale dhe pyjore.

Neni 5

#### Kohezgjatja

Shoqeria do te zhvilloje aktivitetin e saj per nje periudhe kohore te pakufizuar, duke filluar nga data e regjistrimit ne QKB.

## KREU II KAPITULLI

Neni 6

#### Kapitali themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqerise eshte 100 lekë dhe eshte nënshkruar nga "ortaku i vetem " i shoqerise :

**Ortaku Themelues:Aurela Dulla**, zoternes i 1 (nje ) kuote , me vlere te pergjithshme 3.000.000 Leke, qe perbene 100 % te kapitalit themeltar te shoqerise.

Pjesët e kapitalit themeltar nuk mund të përfaqësohen nga letra me vlerë të tregtueshme.

Kontributi i ortakëve mund të jetë në para ose në natyrë (pasuri të luajtshme/të paluajtshme apo të drejta)

Ortaku pergjigjet per humbjet e shoqerise perkundrejt te treteve deri ne vleren e kontribuit te tij ne kapitalin themeltar te shoqerise;

Ky kapital do te ngurtesohet ne Banke pas regjistrimit te shoqerise ne QKB.

Neni 7

#### Zmadhimi dhe zvogelimi I kapitalit

Kapitali i shoqerise mund te zmadhohet nepermjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributiveve në natyrë, dhe ne sherbime, nepermjet emerimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar per keto kontribute ne natyre sipas kërkesës së administratorit.

Zvogëlimi i kapitalit realizohet me vendim te Ortakut te Vetem në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Projekti i zvogëlimit të kapitalit u komunikohet

ekspertëve kontabël të autorizuar, në rast se ka të tillë, të paktën 45 ditë përpara datës së mbledhjes së Ortraktut të Vetem të thirrur për të marrë vendim rreth këtij projekti.

Zvogëlimi i kapitalit themeltar në një vlerë më të vogël se ajo e përcaktuar në nenin 6 të këtij statuti, e bën të detyrueshme marrjen e një vendimi prej shoqërisë për zmadhimin e kapitalit themeltar të paktën deri në vlerën minimale. Në rast moszbatimi të kërkesave të këtij paragrafi, çdo personi interesuar mund të kërkojë në rrugë gjyqësore prishjen e shoqërisë. Kjo prishje nuk mund të shpallet, në qoftë se rregullimi është bërë në ditën kur gjykata mblihdhet për të marrë vendim.

Neni 8

Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontribuit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- c) dhurimit;
- d) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim ( akt noterial )

Kalimi i kuotave me shitje apo dhurim apo çdo formë tjetër ( duke përfshirë trashëgiminë ) mund të bëhet vetëm me pelqimin e shoqërisë .

Ne rast tietersimi me kundershperblim do të zbatohet e drejta e parableries se kuotave nga ortaket e shoqërisë .

Personi që kalon kuotën dhe ai që e fiton atë përgjigjen në mënyrë solidarë ndaj shoqërisë për detyrimet që rrjedhin nga zotërimi i kuotës, nga çasti i kalimit të kuotave, deri në çastin e regjistrimit të kalimit të saj ne Qendren Kombetare te Biznesit , sipas nenit 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”. Regjistrimi i kalimit të kuotave ka efekt deklarativ.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## *KREU II*

### *ORGANET VENDIMMARRRESE DHE DREJTUESE*

Neni 9

Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqërisë.

Asambleja e Ortakeve eshte organi i vetem vendimmarres i shoqërisë qe miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara ne ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shqërimin për çështjet e mëposhme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) ndryshimet e statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
- c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;



d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat “c” dhe “ç” të kësaj pike;

dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;

ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;

g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;

gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;

h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;

i) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.

Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme.

Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

**Cdo ortak ka të drejta vote në përpjestim me vlerën nominale të kuotes së tij.**

#### Neni 10

Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkrësë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkrësë apo me mesazh elektronik duhet të përmbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpara datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

#### Neni 11

Marrja e vendimeve

Asambleja e përgjithshme vendos me të paktën e tri të katërtat e votave të zotëruesve të kapitalit, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Asambleja e përgjithshme vendos **vendos me votat e të paktën tri të katërtave të**

**zotëruesve të kapitalit të shoqërisë.**

Asambleja e përgjithshme **vendos me të njëjten shumicë të cilesuar edhe për çështje të tjera si :**

, për çështje të tjera si :

a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;

b) emërimin e shkakimit i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;

c) përcaktimin e shpërblimeve

- d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
- e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
- f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- Cdo ndryshim statuti duhet të depozitohet pranë QKR për të pasyqruar ndryshimet në skeden e shoqërisë.

Neni 12

Administrimi

Shoqëria do të administrohet nga një administrator.

*Administrator i shoqërisë është Znj. AURELIA DULLA e cila do të ushtroje funksionet në këtë detyrë për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë ripërteritje*

**Administratori zgjidhet me votat e të paktën tri të katërtave të zotëruesve të kapitalit të shoqërisë.**

Asambleja e përgjithshme mund të shkarkojë administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Statuti, apo marrëveshje të tjera nuk mund të përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Përveç kësaj, administratori shkarkohet nga gjykata për shkelje të ligjit me kërkesë të çdonjërit prej ortakëve.

Tagrat e përfaqësimit të administratorit dhe çdo ndryshim i tyre njoftohen për regjistrim pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit.

Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit.

Neni 13

Viti Financiar

Viti financiar i Shoqërisë fillon me 1 Janar dhe përfundon me 31 Dhjetor. Përfundimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendren Kombëtare të Regjistrimit dhe mbyllet me 31 Dhjetor.

Neni 14

Bilanci i shoqërisë dhe dividendet

Brenda 6 muajsh nga mbyllja e vitit financiar, Mbledhja e Ortakut të Vetem, miraton bilancin e paraqitur nga Administratori.

Mbledhja e Ortakut të Vetem vendos rreth shpërndarjes së dividendit, pasi të jënë zbritur humbjet e vitit të mëparshëm financiar, siç edhe parashikohet nga ligji.

Neni 15

Ekspertët

Eksperti ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabel të veprimtarisë ekonomiko tregtare të shoqërisë, atë gjithëvjetor dhe atë në lidhje me kontrollin periodik të ushtruar prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakut të vetem.

Në përfundim të kontrollit eksperti kontabel i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit financiar vjetor si dhe për atë për kontrollin periodik të ushtruar, të cilat është i detyruar që t'i paraqesë e dorëzojë në kohë ortakut për t'i shqyrtuar

e miratuar mbi bazen e të drejtes vendimore qe ka.

#### Neni 16

Të ardhurat neto ( Dividenti ) qe mbeten pas vecimit të fondeve ligjore të mesiperme dhe të atyre per shlyerjen e cdo detyrimi fiskal apo likuidimin e pagesave ndaj të treteve, i mbeten dhe i kalojne ne pronesi, ortakut te vetem të shoqerise.

#### Neni 17

*Shpërndarja ose prishja e shoqerise mund të behet ne cdo kohe :*

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të ortakut te vetem;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- e) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”;
- d) me vendim të gjykatës;

Ne kete rast Asambleja e Ortakeve merr vendim me shkrim ne të cilin parashikon menyren e likuidimit të shoqerise, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shenuar ne cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emnetesen shrese “ Shogeri ne likuidim e siper “.

Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Asambleja e Ortakeve .

Nëse Asambleja e Ortakeve nuk merr një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

#### Neni 18

Likuiduesi merr përsipër të drejtat dhe detyrimet e administratorëve nga data e emërimit të tij. Nëse shoqëria emëron më shumë se një likuidues, përveçse kur akti i emërimit parashikon se ata veprojnë veçmas njëri-tjetrit, likuiduesit ushtrojnë bashkërisht të drejtat e detyrimet sipas këtij ligji. Likuiduesit mund të autorizojnë njërin prej tyre të kryejë veprime të një kategorie të posaçme.

Kufizimet e tagrave të likuiduesve u kundrejtohen të tretëve, në përputhje me përcaktimet e ligjit.

Likuiduesi u nënshtrohet mbikëqytjes së ortakut dhe administratorit.

#### Neni 19

##### Të drejtat e detyrimit e likuiduesit

1. Detyra e likuiduesve është mbyllja e të gjitha veprimeve të shoqërisë, mbledhja e kredive të paarkëtuara dhe e kontributeve të pashlyera, shija e pasurive të shoqërisë dhe shlyerja e kreditorëve duke respektuar radhën e referimit, sipas nenit 605 të Kodit Civil.

2. Likuiduesi mund të kryejë edhe veprime të reja tregtare, për mbylljen e një veprimi të papërfunduar.

3. Nëse, në bazë të padive të ngritura nga kreditorët, sipas nenit 194 të ligjit “ Per Tregtarët dhe Shoqerite Tregtare “, likuiduesit vërejnë se pasuria e shoqërisë tregtare, përfshirë kontributet e pashlyera, nuk është e mjaftueshme për pagesën e këtyre pretendimeve,

likuidesit detyrohen ta pezullojnë procedurën e likuidimit e t'i kërkojnë gjykatës përkatëse nisjen e procedurave të falimentimit.

Likuidesi përgatit një bilanc të gjendjes së shoqërisë në çastin e hapjes së likuidimit dhe një bilanc përfundimtar në çastin e mbylljes së këtyre procedurave. Nëse procedura e likuidimit zgjat më shumë se një vit, likuidesi përgatit, gjithashtu, pasqyrat financiare vjetore të shoqërisë. Bilancet në shoqëri kolektive dhe komandite miratohen nga ortakët e tjerë, ndërsa në shoqëritë aksionare apo nga ato me përgjegjësi të kufizuar miratohen nga asambleja e përgjithshme.

*Neni 20*

*Përfundimi i likuidimit*

Pas shpërndarjes së aktiveve të mbetura, likuidesi e njofton Qendrën Kombëtare të Regjistrimit për përfundimin e likuidimit dhe kërkon çregjistrimin e shoqërisë, në përputhje me seksionin V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit”

*Neni 21*

*Bashkimi*

Dy ose më shumë shoqëri mund të bashkohen nëpërmjet:

1. Kalimit të të gjitha aktiveve e pasiveve të njëtrës ose më shumë prej shoqërive, që quhen shoqëritë e përtithura, të një shoqëri tjetër ekzistuese, e quajtur shoqëria përtithëse, në këmbim të aksioneve apo kuotave të kësaj shoqërie. Ky proces quhet bashkim me përtithje.
2. Themelimit të një shoqërie të re, tek e cila kalohen të gjitha aktivet e pasivet e shoqërive ekzistuese, që bashkohen në këmbim të aksioneve apo kuotave të shoqërisë së re. Ky proces quhet bashkim me krijim i një shoqërie të re.

*Neni 22*

*Ndaria*

1. Një shoqëri mund të ndahet me vendim të Asamblesë së Ortakeve , duke transferuar të gjitha aktivet e pasivet e veta në favor të dy ose me shumë shoqërive ekzistuese apo të themeluara rishitazi. Shoqëria që ndahet, vlerësohet e prishur.
  2. Për ndarjen e shoqërisë zbatohen përkatësisht dispozitat e neneve 216 deri në 225 të ligjit 9901 date 14.04.2008..
  3. Shoqëritë, që fitojnë pasuritë e shoqërisë që ndahet, quhen shoqëri pritëse dhe përgjigjen në mënyrë solidare për detyrimet e kësaj të fundit.
  4. Regjistrimi i ndarjes së shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Regjistrimit ka si pasojë: kalimin te shoqëritë pritëse të të gjitha aktiveve e pasiveve të shoqërisë që ndahet, në përputhje me raportin e ndarjes, të përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes. Ky kalim sjell pasoja për marrëdhëniet ndërmjet shoqërive, si dhe për palët e treta; bëjten e aksionarëve/ortakëve të shoqërisë që ndahet aksionarë apo ortakë të një ose më shumë shoqërive pritëse, në përputhje me raportin e ndarjes, përcaktuar në marrëveshjen e ndarjes;
- vlerësimin e shoqërisë që ndahet si e prishur dhe çregjistrimin e saj nga Qendra Kombëtare e Regjistrimit, sipas seksionit V të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 “Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit” pa kryerjen e likuidimit.

*Neni 23*

*Shndërrimi*

Shoqëria mund ta ndryshojë formën e vet ligjore, nëpërmjet shndërrimit të saj në shoqëri aksionare  
Shndërrimi nuk sjell pasoja mbi të drejtat e detyrimit, që shoqëria ka marrë përsipër ndaj të tretëve.

Neni 24

Baza Ligjore

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e tij ne përputhje te plote me kete statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.

Per sa nuk parashkohet ne kete statut, do te zbatohen dispozitat e ligjit "Per tregtaret dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfaredo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

Neni 25

Mosmarveshjet

Per mosmarveshjet qe mund te lindin ne lidhje me zbatimin apo interpretimin e ketij statuti, si dhe per çdo mosmarveshje qe mund te linde midis Shoqërisë dhe te treteve, do te jete kompetente Gjykata Shqiptare.

Neni 26

Dispozita perfundimtare

Ky Statut u redaktua ne 4 ekzemplare me vlera te njejta juridike ne gjuhen shqipe, dhe pasi in lexua ortakut , nenshkrubet me vullnetin e tij te lire nga ortaku themelues.

**ORTAKU I VETEM**

*Arnela Pulla* 